



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 74/2014, “PËR ARMËT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

Në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 14, bëhet ndryshimi, si më poshtë:

1. Shkronja “dh”, e pikës 1, ndryshohet me përmbajtjen si vijon:
“dh. licencë për tregtimin e armëve të kategorisë “B” dhe për import dhe tregtim të armëve të kategorisë “C” (gjahut) dhe “D” (sportive), pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.”

Neni 2

Në nenin 18/2, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i nenit, ndryshohet dhe zëvendësohet me përmbajtjen si vijon:
“Licenca për tregtimin e armëve të kategorisë “B” dhe për import dhe tregtim të armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.”
2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, më përmbajtjen si vijon:
“1.1 Për veprimtarinë e tregimit të armëve të kategorisë “B”, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, që përfshihen në fushën e veprimt të këtij ligji, lëshohet licencë nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit.”
3. Në pikën 2, fjala “...këtë...” zëvendësohet me fjalën “...këto...”.

Neni 3

Në pikën 1, të nenit 19, pas fjalës “...transportit...” shtohet fjala “...,tregtimt,...”.

Neni 4 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

LINDITA NIKOLLA